



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË
BASHKISË SHKODËR”**

Konsultim publik : Rajoni nr.1.

Data : 17.09.2025

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 24, nga të cilat 6 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Rudin Beka, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr fillimisht Z.Besmir Nabolli, administrator i Rajonit nr.1 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.1 të qytetit.

Vijon me fjalën e tij Zv kryetari i Bashkisë **Z.Rudin Beka**, duke listuar një sërë punësh të kryera në rajonin nr.1 dhe duke prezantuar projektet kryesore:

- Kapotat e pallateve në Parrucë- Xhabije.

- Projekti i tregut të Zdrales.
- Rruga Shirokë- Zogaj.
- Rruga dhe hyrja e qytetit, Bahçallek- Bërdicë.
- Rikonstruksion total i shkollës “Ndre Mjeda”
- Parku i qytetit.
- Rruga e biçikletave dhe e këmbësorëve.
- Është kryer investim në bllokun e pallateve, rruga “Vëllezërit Frashëri”.
- Presim dy investime të rëndësishme në këtë rajon për shkollën “Ismail Qemali”.
- Presim të filloj edhe investimi për kopshtin “Bep Tusha”.
- Po ashtu së shpejti do edhe investimi për fushat dhe këndet e fëmijëve në rajonin nr.1.

Z. Kujtim Kokaj, banor në rrugën “Ethem Kazazi”:

- Kemi bërë një kërkesë në Bashki për rrugën “Ethem Kazazi”, sepse është bërë një kanalizim i ujërave të zeza në këtë rrugë me puseta dhe të gjitha, por nuk është bërë lidhja e këtij kanali me shtëpitë. Është situatë shumë problematike dhe presim të vepohet nga ana e Bashkisë.
- Po ashtu kemi nevojë edhe për një kazan mbeturinash pranë kësaj rruge, duhet të verifikohet mundësia për të vendosur edhe një pikë grumbullimi.
- Gjithashtu nuk kemi ndriçues mjaftueshëm.

Sqaron nga administrata **Z. Altin Salihi** duke thënë se kazanat e koshave mund të vendosen por duhet të kemi edhe hapjen e rrugës sepse nuk kanë ku të kalojnë mjetet e transportit të kazanëve, prandaj sapo të hapet rruga aty, brenda javës vendosim kazanë të rinj. Kurse në lidhje me ndriçimin , do të planifikojmë të tjerë për investim në vitin tjetër.

Z. Rasim Hasani, banor i lagjes “Ahmet Haxhia” Udhakryq:

- Në lagjen tonë, në zonën ku unë banjo, nuk kemi as lidhje me ujëra të zeza e as të bardha. Të gjitha rrugët rrotull janë realizuar dhe tek ne nuk ka asnjë investim dhe asnjë nderhyrje.
- Duhet të ketë një ndërhyrje sepse është shumë emergjente.

Banor , Lgj. Guerrile, Rruga “Karvanej”:

- Në zonën tonë mungon ndriçimi.
- Kur ka rreshje rrugët bëhen të pakalueshme.
- Nuk kemi kanal të ujërave të zeza.

Z. Abdyl Rasimi, banor në lagjen “Salo Halili” rruga “Osja i Falltores” shprehet se është përfaqësues i tre pallateve në këtë lagje:

- Shqetësimi jonë kryesor për pallatet tek zona e quajtur “Shpia e Mushkajes” është se nuk kemi ndriçim.
- Makina e Zjarrfikëses dhe ambulanca nuk mund të kalojnë nga avullit dhe ndërtimet në hapësirat publike.

- Kemi problem edhe me uëjrat e bardha sepse një rreshje e bën të pakalueshëm sheshin dhe rrugën tonë.

Përsëri sqaron **Z.Salihi** nga administrata e Bashkisë duke thënë se do e verifikojmë mundësinë për të vendosur ndriçues shtesë.

Zv. Kryetari Z.Beka thotë se kemi një urdhër pune në fuqi për zenien e hapësirave publike dhe bllokimet e kalimeve dhe së shpejti do të jetë momenti për të ndërhyrë edhe ne zonën tuaj. Po veprohet në bulevardet kryesore dhe është drejt përfundimit, në vijim do të vazhdohet edhe ne lagjet e qytetit dhe brenda tyre.

Znj. Leonora Milani, banore në Lgj. Kiras:

- Kemi bërë një kërkesë që vjet tek Bashkia dhe nuk kemi akoma një ndërhyrje në rrugët e zonës tonë, është emergjent asfaltimi i tyre.
- Duke qenë se është e nevojshme edhe banorët janë gati të bashkëpunojnë, madje i kemi bërë vetë kanalizimet e ujërave të bardha por kemi nevojë për ndërhyrjen tuaj.
- Personalisht jam arkitekte dhe urbaniste dhe shpresoj të kem mundësinë të asistoj.

Z. Pavli Marku, banor i Lgj.nr.1:

- Kam dy sygjerime, së pari orari për këtë takim është i papërshtatshëm dhe së dyti nuk jemi njoftuar në menyrën e duhur.
- Dua të falenderoj për punën e bërë pranë rrugës “Isuf Sokoli”, por me shirat e para asfaltimi në këtë bllok është dëmtuar dhe duhet të monitorohet, të komunikohet me firmën e zbatimit duke qenë se është brenda garancisë.
- Edhe në lidhje me kabujt duhet të sistemohen ato që janë të varur në pallate sepse po dëmtohet edhe ai investim që është bërë.
- Parkimet publike poshtë pallatit janë të zëna me stola , biçikleta , goma dhe objekte nga bizneset. Kërkojmë vëmendje për këtë lagje. Edhe trotuari në këtë rrugë është përheër i zënë me parkime
- Kemi edhe problem me zënien e hapësirave ku nuk mund të kaloj as makina zjarrfikëse.
- Tek korsitë e biçikletave në unazën perëndimore ka problem me kapaket e pusetave dhe duhet të ndërhyhet për të siguruar aksesin dhe ruajtur përdoruesit e biçikletave.

Zv. Kryetari vijon sqarimin duke thënë se jemi në proces të vazhdueshëm me pastrimin dhe lirim të hapësirave publike, por duket se ndërgjegjësimi i banorëve është vështirë por po bëhet një punë e vazhdueshme nga të gjitha strukturat e Bashkisë.

Banor i bllokut të pallateve në rrugën “Vëllezërit Frashëri” :

- Kemi emergjente hyrjen e pallatit, pasi është komplet me ujë dhe s’kemi si hymë e dalim. Është shumë e nevojshme të ndërhyhet sepse nuk kemi ku kalojmë.

Z. Agim Tahiri, banor në lagjen “Salo Halili”:

- Në “Bahqen e Çakejve” ka hapësira publike të paërdorura dhe pa asnjë mundësi për parkim apo për stola, prandaj është shumë e nevojshme të ketë një rikualifikim total të këtij blloku pallatesh.
- Duhet parë edhe vlerësuar edhe ujërat e bardha e të zeza.

Znj.Manjola Lika, drejtoreshë e kopshtit “Bep Tusha”:

- Jemi të kënaqur që jemi në proces rikonstruksioni dhe kërkojmë që të mund të përfshihet në këtë ndërhyrje edhe pjesa e jashtme e këtij kopshti.

Banor, Rruga “Selim Çoba”:


- Kemi nevojë të ndërhyhet në rrugën “Elez Abazi” dhe në rrugën “Ali Spahija”

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Z.Rudin Beka**, Zv.Kryetar i Bashkisë mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

Zbardhi proces verbalin .

Bekim Mema

Irma Sulishti



SEKRETARE

Sabina Danaj






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK




LISTË PREZENCË
(Lagjia nr.1)

KONSULTIM PUBLIK: "Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër"

Date: 17.09.2025

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJIA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Adela Smëli Hoxha	Çokësi Kine	0673813312		
2.	Leonora Milani	Kinas/zotekmike	0698150701	milanileonora@gmail.com	
3.	Anila Milani	Kinas/zotekmike	0691037568	anilamilani@hotmail.com	
4.	Neolien Cezari	Kinas/zotekmike	0684731445		
5.	Placet Haxhali	Lagjia 1	0686358123		
6.	Fatima Lulushi	Lagjia Shtete	0688687609	lulushia.nusret	
7.	Albano Hoxhiu	Lagjia 1	0692781284		
8.	Manjola Lika	Dij. Kopsht	0692389870	manjollalika@yahoo.co	

Bep Tushë.

NR.	EMRI MBEEMRI	LAGJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9.	Arifet Behari	D.T.T.V.	0652484025	ArifetBehari@kshksh.com	
10.	Domestela Kodaj	B. Smkoder	0673570001	DomestelaKodaj@kshksh.com	
11.	Flavio Malocaj	B. Shkoder	0684063501	Flavio.Malocaj@kshksh.com	
12.	Agim Tahiri	L. Bishkopi	0632073175	agimtahiri@kshksh.com	
13.	ALTIN MALIHI	MSH PP	0682092590	altinmalihi@kshksh.com	
14.	Artur Hlibashi	A. Haxhia	0695555085		
15.	Gjini Gjoni	Gjini Gjini	0685060233		
16.	Pauli Marku	A. Haxhia	—	—	
17.	Adri Merv	S. Haxhia	0682198068	—	
18.	Jerdet Durr	S. Haxhia	0693200730	—	
19.	Fatbardh Gjish	S. Haxhia	0685214810	—	
20.	Stanimir Hent	E. Haxhia	073886470		
21.	Lejla Gole	G. Haxhia	0642154508		
22.	Adri Merv	H. Haxhia	0692166436	—	
23.	Dejda Durr		068200840		
24.	Ervin Dizdari	Koordinator	0694063981	Ervin.Dizdari@kshksh.com	